



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

VENDIM

Nr. 14, datë 23.05.2025

PËR
MIRATIMIN E “RAPORTIT MBI REALIZIMIN E BUXHETIT
TË AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
PËR TREMUJORIN E PARË TË MBYLLUR NË 31 MARS 2025”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 52 pika 1, shkronja “l”, nenit 53, pika 5, shkronja “ë”, nenit 62 të ligjit nr.53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 20, pika 5 dhe pika 6 i Rregullores nr. 34, datë 27.11.2020 “Për hartimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të nenit 6, pika 2, shkronja “d”, të nenit 8, pika 2, shkronja “m” të Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr.24, datë 31.10.2018, të nenit 18, pika 2 të Rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Raportit mbi realizimin e buxhetit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, për tremujorin e parë të mbyllur në 31 mars 2025”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Sektori i Financës dhe Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.





3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shqipe Malaj

Sekretare

Donald Duraj

Kryetar

